



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Rev.nr.378/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Zenel Leku dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Z.A., nga fshati ..., Komuna e D., të cilin e përfaqëson Avokati Ruzhdi Berisha nga P., kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike SH.A. KEDS – Distrikti në P., të cilën e përfaqëson L. S. nga P., për shkak të anulimit të vendimit dhe kthimit në punë, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3069/21 datë 18.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.09. 2024, mori këtë,

### A K T G J Y K I M

PRANOHET si i themeltë revizioni i të paditurës, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3069/21 dt.18.04.2024 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash C.nr.106/15 dt.25.03.2016, ashtu që: REFUZHET kërkesëpadia e paditësit Z. A., me të cilën ka kërkuar që të anulohen si të kundërligjshme Vendimet e së paditurës KEDS - Drejtorit në Distriktin e Prizrenit nr.2035 dt.27.08.2015 dhe Vendimi i Arbitrit – i Drejtorit në Divizionin e Shërbimeve të Përbashkëta nr..., dt.6.10.2015, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit dhe të detyrohet e paditura KEDS – Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. Distrikti në P., që paditësin ta kthejë në vendin e punës dhe detyrat e punës të ... – ndërrimin e njehsorëve në Departamentin e operimit – operime, ku dhe më parë ka punuar, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe të ia kompensojë shpenzimet

e procedurës kontestimore në shumë prej 509,60 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim përmbarimi të dhunshëm, si e pa bazuar.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3069/21 dt.18.04.2024, është refuzuar si e pa themeltë ankesa e të paditurës KEDS Distrikti në Prizren, ndërsa, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Dragash C.nr.106/15 dt.25.03.2016, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, anulohen si të kundërligjshme Vendimet e të paditurës KEDS, Arbitrit – Drejtorit në Distriktin e Prizrenit, nr.2035 dt.27.08.2015 dhe Vendimi i Arbitrit i Drejtorit në Divizionin e Shërbimeve të Përbashkëta nr.8243 dt.6.10.2015 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit Z. A. nga fshati ..., Komuna e D. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, detyrohet e paditura, që paditësin, ta kthejë në punët dhe detyrat e punës të çkyqësit – ndërrimin e njehsorëve në Departamentin e Operimit, ku edhe ka punuar më parë, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe të ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm dhe me pjesën e III të dispozitivit, obligohet e paditura që ti bartë shpenzimet e procedurës, paditësit të ia paguajë shumën prej 509,60 euro.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor e paditura ka paraqitur revizion , për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, të miratohet revizioni si i themeltë, të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3069/21 dt.18.04.2024, ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit, si e pabazuar ose të anulohet plotësisht aktgjykimi i shkallës së dytë dhe e njëjta çështje të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së dytë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK –së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion, si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi, te e paditura ka qenë i punësuar në kohë të pacaktuar, ka punuar si çkyqës – ndërrimin e njehsorëve në Departamentin e operimit, mirëpo, kontestuese ishte ligjshmëria ose jo e vendimeve të së paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit. Nga procesverbali i Departamentit – Sektori Qendra e Kalibrimit me nr.4968 dt.29.04.2015, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se njehsori elektrik me nr.1., pllombat e prodhuesit i ka të falsifikuara pas të cilit ka rezultuar fletëparaqitja për procedurën disiplinore, deklarata e paditësit, procedura disiplinore, dhe vendimet e të paditurës. Nga leximi i kontratës së punës nr..., dt.20.04.2015, nën pikën 1 të kësaj kontrate vërtetohet se paditësi me të paditurën këtë kontratë e kanë lidhur në kohë të pacaktuar, prej dt.20.04.2015, me titullin – pozitën e sipër përmendur të punës, për të theksuar më tutje, se me nenin 11 të kontratës parashihet edhe ndërprerja e marrëdhënies së punës konform nenit 70 dhe nenit 71 të Ligjit të Punës, por që, nuk janë respektuar nga e paditura. Nga leximi i përshkrimit të detyrave të punës nga Departamenti i operimeve të KEDS –it dt.19.05.2015, gjykata vërteton, se paditësi është i caktuar në leximin, çkyqjen dhe ndërrimin e njehsorëve pranë të paditurës.

Nga leximi i fletëparaqitjes për procedurë disiplinore me nr.6095 dt.29.07.2015, vërtetohet se personi pranë KEDS-sit që më dt.27.07.2015, raporton shkeljen sipas procesverbalit të Qendrës së Kalibrimit në Prishtinë, që rezulton se njehsori elektrik pllombat i ka të falsifikuara, e nga ky veprim ekziston dyshimi i bazuar i shkeljeve të rënda të detyrave të punës të punëmarrësit – paditësit, nga neni 7.1 nënp.(f) pika i dhe ii të Kodit Disiplinor të KEDS-it. Nga leximi i vendimit nr.2035 dt.27.08.2015 i Arbitrit – Drejtorit F. B., në Distriktin e P., paditësit pas kontrollimit të njehsorit në Q. e K. i është shkëputur kontrata e punës me arsyetimin se njehsori ka pllombat e falsifikuara dhe në brendi të numrave ka gërvishtje të numrave në numratorë, me çka ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës nga neni 7.1, nënp.(f) pika (i) dhe (ii) të Kodit Disiplinor të KEDS-it, i ndërpritet kontrata e punës nga dt.27.08.2015, pa periudhë të paralajmërimit dhe se asnjëherë nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, ndaj, gjykata e shkallës së parë, thekson më tej, se këto vendime të së paditurës janë në kundërshtim me nenin 70 par.1 pika 1.6, 1.6.1 dhe 1.6.2 të Ligjit të Punës. Nga shiqimi i procesverbalit për ndërrimin e njehsorit dhe dëftesa nr..., në emër të paditësit më dt.4.10.2004, vërteton se paditësit, nga ana e dy anëtarëve4 të Komisionit të KEK-ut, i është hequr njehsori me nr.të fabrikës ..., dhe është vendosur njehsori me nr. ..., e në të cilin është vendosur pllomba nr... Nga leximi i përfundimit të komisionit verifikues pranë KEDS-it me nr..., dt.23.09.2015, ku është shqyrtuar ankesa e punëmarrësit nr..., dt.30.08.2015, vërteton

se ky përfundim i komisionit verifikues është mbajtur më dt.23.09.2015 e jo më dt.14.09.2015, që d.m.th. tetë ditë pas skadimit të afatit të paraparë për shqyrtimin e ankesës së paditësit. Nga procesverbali i seancës disiplinore me nr..., dt.21.08.2015, gjykata e shkallës së parë, vërteton se, që në fillim të këtij procesverbali llojoja e KEDS është përpiluar në tri gjuhë dhe se kjo seancë e Arbitrit – Drejtorit të Distriktit në P., është mbajtur në gjuhën Shqipe pa përkthyes, deri sa paditësi është i përkatësisë mysliman – goran, që në parim janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të parapara me nenin 30 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovës, nenit 5, 24, 31 dhe 59 pika 5 të Kushtetutës së Kosovës etj. Edhe sipas deklaratës së dëshmitarit S.S., të dhënë më dt.25.03.2016, vërteton se me kolegun R. A., ( po ashtu i dëgjuar si dëshmitar) ka qenë në ndërrimin e njehsorit në shtëpinë e paditësit dhe në anën e jashtme nuk ka vërejte ndonjë dëmtim të njehsorit për çka kanë përpiluar procesverbalin dhe çdo gjë me njehsorin elektrik ka qenë në rregull, ndërsa, shiqimin në anën e brendshme të tij e bën Qendra e Kalibrimit.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave dhe gjendjes së këtyllë faktike ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar , ndaj , ka vendosur si në pjesën I, II, dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, duke refuzuar ankesën e të paditurës, ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale , kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndaj, e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë gjendje të çështjes konkrete juridiko – civile, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancave më të ulëta gjyqësore, drejt dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike, mirëpo, në bazë të gjendjes së tillë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kur e kanë miratuar si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, për të cilën arsye u dashtë që të pranohet revizioni i të paditurës si i themeltë dhe të ndryshohen të dy aktgjykimet e të dy gjykatave të instancës më të ulët dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar.

Kështu, për arsyet dhe për faktin relevant, se sikundër rezulton nga shkresat e lëndës dhe nga provat e administruara, vendimi i të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është

marrë në përputhje me dispozitat e akteve të brendshme të paditurës, veç tjerash, me dispozitat e nenit 7.1, nënp. (f) ( vjedhja e çfarëdo aseteve të KEDS-it...), pika (i) ( shfrytëzimi i pa autorizuar i energjisë elektrike), dhe (ii) (keqpërdorimi i njehsorëve apo i pajisjeve të energjisë elektrike), dhe nenit 50 par.3 të Kodit Disiplinor dhe Kodit të Punës të së paditurës, përkatësisht, nenit 70, nenit 71, nenit 85, nenit 86 të Ligjit të Punës, të cilat dispozita parashohin, përkatësisht, rregullojnë rastet dhe konditat ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të cilat në rastin konkret, ishin përmbushur. Në kontekstin e mësipërm, duhet theksuar faktin se në shkresat e lëndës ka prova të cilat vërtetojnë katërçipërisht, se vendimit të sipër përmendur të së paditurës i ka paraprirë zhvillimi i procedurës disiplinore nga organi kompetent i saj, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në harmoni me aktet e brendshme të saj, ( me procesverbalin e nënshkruar pa vërejtje edhe nga paditësi) dhe pa kurrfarë diskriminimi, ka vërtetuar shkeljen e rëndë të detyrave të punës ( siç rezulton edhe nga procesverbali nr..., dt.28.04.2015 i Departamentit AMR e Kalibrim, Sektori Qendra e Kalibrimit nj.org.02 nr..., dt.29.04.2015, Prishtinë, me të cilin veç tjerash, është konstatuar se njehsori elektrikë në fjalë, nr..., , pllombat e prodhuesit i ka të falsifikuara, në brendi të njehsorit komisioni ka vërejtë se : Numruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numratorë. Shifra e tretë nr.03 shifra e katërt nr.2 në T1 dhe shifra e parë nr.8 shifra e pestë nr.2 ne T2), dhe ekzistimin e përgjegjësisë disiplinore të paditësit, pra, ka vërtetuar në mënyrë ligjore se paditësi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës, për çfarë i ka shqiptuar masën përkatëse disiplinore të paraparë me dispozitat e përmendura ligjore dhe me aktet e brendshme të së paditurës.

Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, ndaj, nga këtu dhe nga arsyet e sipër përmendura, i ndryshoi aktgjykimet e tyre dhe refuzoi padinë si dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.378/2024 datë 12.09.2024,

Kryetari i kolegjit,  
Mr.sc.Muhamet Rexha

